

AKT I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Albinvestment” SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datën 12/11/2023, unë Gentian Nebiaj, lindur më 07/08/1981, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i pajisur me Letërnjoftimin ID me nr.Personal 110807057V, në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, vendosa të themeloj një shoqëri tregtare, sipas akt-themelimit me përmbajtjen dhe të dhënat, si më poshtë:

Neni 1

Emri, Forma ligjore e Shoqërisë

1. Emri i Shoqërisë është “Albinvestment” SH.P.K.
2. Shoqëria “Albinvestment” SH.P.K. është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
3. Shoqëria do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në mbështetje të Statutit, që i bashkëlidhet këtij Akt-Themelimi.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Pallati 7, Ap.7.
2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë filiale të tjera, degë, zyra përfaqësie, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të organit administrativ dhe pas miratimit nga organet kompetente.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Ortakut të Vetëm, në çdo kohë dhe për çdo shkak.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por pa u kufizuar në të:

- veprimtaria tregtare;
- ndërtimi, zhvillimi dhe pjesëmarrja në investime për zhvillimin e pasurive të paluajtshme;



- blerja dhe shitja, marrja dhe dhënia me qira, enfiteozë, në huapërdorje ose në çfarëdo lloj forme tjetër të pasurive të luajtshme/të paluajtshme;
- administrim, konsulencë, në fushën e investimeve të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
- projektim planesh të detajuara vendore; projektim arkitekturor për objekte banimi, objekte industriale, objekte turistike, interiere, peizazhe, sipërfaqe të gjelbra, lulishte dhe parqe;
- ndërtimi, restaurimi dhe mirëmbajtja i të gjitha llojeve të ndërtesave, rezidenciale, jorezidenciale, industriale, ndërtesa qytetëse dhe vepra të lidhura e plotësuese, konstruksione të ndryshme brenda fushës së ndërtimit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve;
- aplikim për leje ndërtimi online me nënshkrim elektronik;
- ndërtimi, implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, si dielli, era, uji, si dhe i veprave të tyre ndihmëse; marrjen e të gjitha lejeve, licensave, autorizimeve paraprake/përfundimtare, por pa u kufizuar në to, nga të gjitha institucionet përgjegjëse shtetërore, vendore apo qendrore, arritjen e marrëveshjeve me subjektet privatë të së drejtës, vendas apo të huaj, të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre lloj aktiviteteve në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- shitja me shumicë apo pakicë e energjisë elektrike të operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike, vendas apo të huaj, si dhe në bursën shqiptare të energjisë elektrike, apo në bursa të tjera të energjisë elektrike jashtë vendit;
- tregtia me shumicë dhe me pakicë e artikujve të ndryshëm;
- importimi, eksportimi dhe tregtimi i lëndëve të para e prodhime të përfunduara, duke përfshirë tregtimin e tyre në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi;
- pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive të treta;
- veprimtaria në fushën e turizmit, hotelerisë;
- ndërtim, arëdim, dizejnim të dhomave të hotelerive, marrja dhe dhënia me qira e strukturave të ndryshme akomoduese turistike;
- aktivitet në fushën e agro-turizmit;
- dhënia e konsulencës ligjore dhe ofrimi i asistencës juridike;
- përfaqësimi ligjor/gjyqësor;
- ofrimi i konsulencës ekonomiko-financiare dhe i ekspertizës kontabilistike;
- veprimtari të lidhura ose të ngjashme me objektin e Shoqërisë.

Neni 5 Kapitali i Shoqërisë

1. Kapitali bazë i Shoqërisë është 100,000 l (njëqind mijë lekë). Shumat e derdhura për formimin e kapitalit, do të vërtetohen me anë të dokumentit të lëshuar nga banka.
2. Ortaku i Vetëm Gentian Nebiaj, është kontribues në vlerën 100,000 lekë.
3. Numri total i kuotave është 1 (një).
4. Zotërimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë nga Ortaku i Vetëm është në masën 100 %.
5. Shoqëria “Albinvestment” SH.P.K., kapitali i së cilës ndahet në kuota, përballon humbje nga Ortaku i Vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar të regjistruar në QKB.



Neni 6
Organet drejtuese

1. Organet e Shoqërisë, janë Ortaku i Vetëm dhe Administratori.
2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në këtë Akt-Themelim dhe në Statutin e Shoqërisë.

Neni 7
Organi vendimmarrës

1. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas kushteve të përcaktuara në ligj.
3. Ortaku i Vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga Administratori.
4. Ortaku i Vetëm mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

Neni 8
Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë drejtohet nga Administratori i Shoqërisë.
2. Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga Ortaku i Shoqërisë.
3. Vendimet e Ortakut të Vetëm, mund të merren edhe përmes konsultimit me shkrim.

Neni 9
Administrimi

1. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.
2. Ortaku i Vetëm vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.
3. Administratori/rët mund të jenë ose jo ortakë.
4. Ortaku i Vetëm, zgjedh si Administrator të Shoqërisë, Z. Gentian Nebiaj.
5. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
6. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publikë dhe/ose privatë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu organet gjyqësore të të gjitha shkallëve.
7. Administratori është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe karakterin sekret të dokumentacionit të Shoqërisë, eksperiencës së shkëmbyer e të realizuar gjatë veprimtarisë së Shoqërisë.
8. Më gjerësisht, kompetencat e Administratorit të Shoqërisë, rregullat mbi organizimin, drejtimin, administrimin e aktivitetit dhe çështjeve të brendshme të Shoqërisë janë parashikuar në Statutin e saj.



Neni 10
Viti financiar

1. Veprimtaria ekonomiko-financiare e Shoqërisë, fillon më 1 Janar dhe përfundon më datë 31 dhjetor të çdo viti.
2. Përyjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.

Neni 11
Prishja, likuidimi

Shoqëria priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, ose sipas ligjit. Me mbarimin e saj, Shoqëria vihet në likuidim.

Neni 12
Legjislacioni i zbatueshëm

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përcaktimet e këtij Akt-Themelimi dhe parashikimet e Statutit të Shoqërisë.

Neni 13
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të moszgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do të paraqiten për zgjidhje para gjykatës kompetente shqiptare, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 14
Dispozita të fundit

1. Akt-Themelimi u përpilua në prani të Ortakut themelues të Shoqërisë tregtare, që e miraton në tërësi dhe nen për nen atë, dhe e nënshkruan rregullisht me vullnet të lirë dhe të plotë.
2. Akti i Themelimit, përpilohet në katër (4) kopje, me vlerë dhe fuqi të njëjtë ligjore secila, për t'u depozituar në organet shtetërore dhe një kopje e cila ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES
I
SHOQËRISË "Albinvestment" SH.P.K.

Gentian Nebioj